



Kuvendi i Anëtarëve të Odës Tregtare Kosovaro-Turke, i mbledhur në Prishtinë më 28 qershor 2016, në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligjet e Kosovës dhe në nenin 6 dhe 17 të Statutit të Odës Tregtare Kosovaro-Turke të datës 31 korrik 2012, miratoi ndryshimet e tij dhe vuri në fuqi këtë:

STATUT të Odës Tregtare Kosovaro-Turke

Neni 1 – Dispozitat e përgjithshme

1. Ky Statut përbën aktin më të lartë normativ i cili qeverisë mbi shoqatën jofitimprurëse me emrin Kosova Turkiye Ticaret Odasi Dernegi (të cilës në vijim të këtij Statuti do t'i referohet me *Oda*), të themeluar në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Shoqatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës (Ligji Nr. 04/L-057), të cilit do t'i përmbahen të gjitha organet e Odës dhe i cili do të shërbejë si udhërrëfyes për tërë veprimtarinë e saj.
2. Ky Statut rregullon emrin, selinë, formën e rregullimit, veprimtarinë dhe objektivat e Odës, përcakton mënyrën e fitimit të anëtarësisë, organet e Odës, modalitetet e veprimit të organeve të Odës, si dhe raportet juridike të Odës me palë të treta.

Neni 2 – Emri, selia emblema, dhe forma

1. Emri i shoqatës është Kosova Turkiye Ticaret Odasi Dergeni. Shoqata do të identifikohet edhe me përkthimet përkatëse të emrit të saj zyrtar në gjuhën shqipe (Oda Tregtare Kosovaro-Turke) dhe angleze (Kosovo-Turkey Chamber of Commerce).
2. Shoqata do të njihet edhe me shkurtesat përkatëse në gjuhën turke (KTTOD) dhe shqipe (OTKT).
3. Selia dhe adresa e regjistruar e Odës është në Prishtinë, në rrugën Imzot Nikë Prella, numër 42. Selia dhe adresa e regjistruar e Odës mund të ndryshojë me vendim të Bordit të Drejtorëve të Odës.
4. Emblema e Odës përbën ndërthurje të flamujve të Republikës së Turqisë dhe Republikës së Kosovës, të vendosura në formë rrethore, përreth të cilëve është i vendosur mbishkrimi Oda Tregtare Kosovaro-Turke – Kosova Turkiye Ticaret Odasi.
5. Oda është shoqatë jofitimprurëse, sipas definimit të dhënë në nenin 5.3 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.



6. Oda nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo të ardhure neto ose fitimi si të tillë për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të Odës. Megjithatë, për punonjësit e Odës dhe për personat dhe subjektet që ofrojnë shërbime për Odën do të sigurohet kompensim adekuat.

7. Oda mund të ofrojë shërbime të ndryshme dhe të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së veprimtarisë së saj jofitimprurëse, në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe të Ligjit për Lirim të Asociimit në OJQ 04/L-57, me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike në fjalë të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.

Neni 3 – Themeluesit dhe përfaqësuesit zyrtarë të Odës

1. Themelues të Odës janë:

- a. Banka Kometare Tregtare, BKT Prishtinë
 - b. TEB sh.a., Prishtinë
 - c. Atlantik Group, Prishtinë
- (lista)

2. Përfaqësues zyrtarë të Odës do të jenë Kryetari i Odës, për të gjitha funksionet protokolare, dhe Drejtori Ekzekutiv i Odës, për të gjitha funksionet operative dhe administrative.

3. Drejtori Ekzekutiv i Odës do të përfaqësojë Odën pranë autoriteteve në Kosovë dhe jashtë saj dhe do të pranojë të gjitha shkresat zyrtare në emër të Odës. Drejtori Ekzekutiv do të jetë përgjegjës për njoftimin e autoriteteve përkatëse administrative për çfarëdo ndryshimi në Odë.

Neni 4 – Qëllimi dhe veprimtaria e Odës

1. Qëllim parësor i Odës është të ofrojë përkrahje për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe krijojë hapësirë për investime të ndërsjella mes Turqisë dhe Kosovës, të nxisë këmbimet tregtare dhe bartjen e dijenisë dhe përvojës në tregti, të rrisë bashkëpunimin bilateral, si dhe të motivojë bashkëpunim tregtar, financiar, investues dhe ekonomik të mëtejshëm mes dy vendeve.

2. Qëllim specifik i Odës është që të mbrojë të drejtat dhe interesat kolektive të anëtarëve të saj pranë organeve publike në Kosovë dhe Turqi, të motivojë ortakëri mes dy vendeve dhe të ndihmojë në stimulimin e investimeve të Turqisë në Kosovë. Çdo veprim i Odës do të jetë në



shërbim të zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike që sjellin përfitime për anëtarët e saj dhe Kosovën dhe/ose Turqinë në përgjithësi.

3. Oda do të përmbahet nga lobimi për të drejtat dhe interesat e ndonjë anëtari individual në rast se ato nuk përkrijnë me të drejtat dhe interesat e përgjithshme të anëtarëve të Odës. Oda do të përmbahet edhe nga lobimi për të drejtat dhe interesat e një dege të caktuar ekonomike, në rast se interesi në fjalë nuk përkrijnë me të drejtat dhe interesat e përgjithshëm të anëtarëve të Odës.

4. Veprimtaria dhe punët në vijim do të jenë, mes tjerash, disa prej angazhimeve parësore të Odës dhe të gjitha organeve të saj:

- Kontribuimi në zhvillimin e marrëdhënieve ekzistuese ekonomike mes Kosovës dhe Turqisë.
- Angazhimi për zgjidhjen e problemeve eventuale tregtare dhe ekonomike mes Kosovës dhe Turqisë.
- Sajimi i mekanizmave për evidentimin dhe mbrojtjen e interesave të anëtarëve të shoqatës.
- Ofrimi i shërbimeve këshillëdhënëse për çështje tatimore, doganore, juridike, valutore, kreditore e të ngjashme për anëtarët e Odës.
- Organizimi i takimeve, mbledhjeve dhe ngjarjeve të tjera mes anëtarëve të shoqatës dhe palëve tjera me interes për të shqyrtuar dhe diskutuar zhvillimet aktuale ekonomike.
- Organizimi i seminareve, konferencave dhe takimeve të ngjashme me qëllim të realizimit të qëllimeve të Odës, promovimit të punës dhe angazhimeve të Odës dhe anëtarëve të saj dhe edukimit të anëtarëve të saj dhe komunitetit të biznesit në Kosovë në përgjithësi.
- Organizimi i panaiereve tregtare dhe të natyrave tjera dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së anëtarëve nëpër panaiere të organizuara nga partnerët e Odës.
- Krijimi dhe mbajtja e kontakteve me publikun me qëllim të ruajtjes së interesave bilaterale ekonomike.
- Realizimi i hulumtimeve ekonomike dhe tregtare, analizave të tregut, raporteve të fizibilitetit, ekskursioneve tregtare dhe fushatave të ndryshme me qëllim të avancimit të qëllimeve të Odës dhe objektivave të anëtarëve të saj.
- Ofrimi i mostrave të kontratave, marrëveshjeve, akteve tjera normative dhe juridike për anëtarët e saj.
- Ofrimi i këshillave, rekomandimeve dhe propozimeve tregtare, juridike e të natyrave tjera për anëtarët e vet, duke marrë parasysh natyrën joobligative të tyre dhe shprehimisht duke mohuar çfarëdo përgjegjësie për pasojat që të njëjtat mund të kenë për anëtarët.



- Bashkëpunimi me odat tjera ekonomike në Kosovë, Turqi dhe vendet tjera, si dhe me të gjitha organizatat dhe shoqatat që kanë për qëllim avancimin e tregtisë dhe ekonomisë.
- Ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit apo arbitrazhit, në rast të paraqitjes së kërkesës nga ana e anëtarëve, me qëllim të ndërmjetësimit dhe tejkalimit të mosmarrëveshjeve mes anëtarëve.
- Zhvillimi i programeve të cilat kanë për qëllim forcimin e imazhit të Odës, anëtarëve të saj, akterëve që angazhohen për bashkëpunim më të ngushtë mes Kosovës dhe Turqisë dhe investimeve turke në Kosovë në përgjithësi.
- Sponsorimi i aktiviteteve dhe masave që mund të rezultojnë me rritje të tregtisë dhe investimeve mes Turqisë dhe Kosovës.
- Ofrimi i një forumi për bizneset turke në Kosovë dhe bizneset kosovare në të cilat bizneset turke janë hisedare, me qëllim të identifikimit dhe shqyrtimit të çështjeve që përbëjnë interes të përbashkët.
- Sigurimi i ndihmës për bizneset nga Turqia, në veçanti për ato që rekomandohen nga Oda Tregtare dhe e Bursave e Turqisë apo autoritetet turke.

5. Tërë veprimtaria e Odës do të jetë publike. Anëtarët e Odës dhe opinioni publik do të informohen rregullisht mbi veprimtarinë e Odës, përmes mjeteve të informimit, web-faqes së Odës, buletineve informative, raporteve dhe njoftimeve të saj.

6. Oda është organizatë apolitike e cila në asnjë kusht apo rrethanë nuk do të përfshihet në grumbullimin e fondeve për të mbështetur ndonjë parti politike apo ndonjë kandidat për funksione politike.

Neni 5 – Anëtarësimi

1. Anëtarësimi në Odë do të jetë i hapur për të gjitha subjektet juridike të cilat pranojnë këtë Statut dhe aktet tjera normative të Odës dhe të cilat kanë interes për të avancuar marrëdhëniet tregtare mes Kosovës dhe Turqisë dhe zhvillimin ekonomik dhe avancimin e biznesit në Kosovë në përgjithësi.

2. Të gjithë anëtarët e Odës do të gëzojnë të gjitha të drejtat e dhëna me këtë Statut dhe aktet tjera normative të Odës në mënyrë të barabartë, pa dallim apo diskriminim të çfarëdo lloji.

3. Kushtet dhe kriteret e anëtarësimit në Odë, si dhe kategoritë e anëtarësimit dhe pagesat vjetore për anëtarësim në Odë do të përcaktohen me Rregulloren për Anëtarësim, e cila do të miratohet nga Bordi i Drejtorëve të Odës, në pajtim me këtë Statut.

4. Anëtarësia në Odë fitohet duke parashtruar kërkesë për anëtarësim në Odë, të cilën e shqyrton Drejtori Ekzekutiv dhe e miraton Bordi i Drejtorëve të Odës, jo më vonë se një dhjetë



ditë pas parashtrimit të saj. Anëtarësia në Odë fillon me momentin e dhënies apo publikimit të njoftimit për miratim të kërkesës për anëtarësim.

5. Të gjithë anëtarët e Odës do të paguajnë rregullisht anëtarësinë vjetore, lartësia dhe kushtet e pagesës së të cilës do të caktohen në Rregulloren për Anëtarësim. PAGESA E RREGULLT E ANËTARËSISË është një nga parakushtet për fitimin dhe mbajtjen e statusit të anëtarit të Odës. Pa paragjykuar kushtet tjera për pezullimin dhe humbjen e statusit të anëtarit të Odës, të cilat mund të përcaktohen në Rregulloren për Anëtarësi, me fillim nga viti kalendarik 2017, nëse cilido anëtar i Odës dështon të paguajë anëtarësinë vjetore për një vit kalendarik, të njëjtit do t'i pezullohet anëtarësia dhe të gjitha të drejtat e privilegjet e gëzuara si anëtar. Për më tepër, nëse cilido anëtar i Odës dështon të paguajë pagesat e anëtarësisë vjetore për dy vite kalendarike, anëtarit në fjalë do t'i ndërpritet anëtarësia në Odë dhe i njëjti do të vendoset në listën e anëtarëve pasivë të Odës.

6. Anëtarësia në Odë mund të pezullohet për një periudhë të caktuar apo revokohet, me vendim të Bordit e Drejtorëve, edhe në rast se anëtar:

- vepron në kundërshtim me këtë Statut, aktet tjera normative të Odës, apo qëllimet e deklaruara të saj.
- ndërmerr iniciativa kundër Odës.
- vepron në kundërshtim me normat dhe rregullat e përgjithshme morale e të mirësjelljes.
- ndërmerr ndonjë veprim i cili dëmton rëndë imazhin e Odës dhe anëtarëve të saj, apo investimeve turke në Kosovë në përgjithësi.

7. Çdo anëtar mund të shkëpusë anëtarësinë në Odë me vetëdëshirë, pasi t'i ketë shlyer ndaj Odës të gjitha obligimet e akumuluar gjatë periudhës së anëtarësisë, përmes paraqitjes së kërkesës për largim nga anëtarësia nga Oda tek Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 6 – Organet dhe strukturat e Odës

1. Organe të Odës janë: Kuvendi i Anëtarëve, Bordi i Drejtorëve dhe Kryetari. Modalitetet e funksionimit të organeve të Odës do të përcaktohen me këtë Statut dhe me rregulloret e veçanta të cilat do t'i miratojnë organet e Odës në bazë të kompetencave statutores të tyre. Të gjitha organet, strukturat dhe punonjësit e Odës do të veprojnë në pajtim me këtë Statut, aktet tjera normative të Odës dhe legjislacionin e zbatueshëm. Çdo shkelje e dispozitave të të njëjtave nga cilido anëtar, organ, përfaqësues apo punonjës i Odës do të konsiderohet bazë e mjaftueshme për humbje të statusit dhe privilegjeve që asocohen me Odën.

2. Oda do ta ketë zyrën dhe stafin ekzekutiv që vepron në bazë të kontratave të punës dhe në pajtim me ligjet e punës në Kosovë, të udhëhequr nga Drejtori Ekzekutiv, i cili emërohet nga Bordi i Drejtorëve. Personat e punësuar në Odë do të kryejnë shërbimet e veta për Odën në bazë të marrëveshjeve për krijimin e marrëdhënies së punës, apo marrëveshjeve mbi vepër,



në të cilën do të specifikohen detyrat dhe lartësia e kompensimit për kryerjen e tyre. Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e punonjësve të Odës do të përcaktohen me rregullore të posaçme të hartuar nga Drejtori Ekzekutiv.

3. Puna e organeve dhe strukturave të Odës do të koordinohet nga Sekretari i Përgjithshëm, nën mbikëqyrjen e Drejtorit Ekzekutiv.

Neni 7 – Kuvendi i Odës

1. Kuvendi është organi më i lartë qeverisës i Odës i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët e Odës. Anëtarët të cilëve u është pezulluar anëtarësia në Odë në pajtim me këtë Statut dhe me aktet tjera normative të Odës mund të marrin pjesë në punimet e Kuvendit vetëm në statusin e vëzhguesit.

2. Kuvendi i Odës është përgjegjës për miratimin e politikave strategjike dhe udhëzimeve financiare për veprimtarinë e Odës.

3. Kuvendi është përgjegjës për zgjedhjen e Kryetarit të Odës, i cili shërben edhe si Kryetar i Kuvendit dhe Kryetar i Bordit të Drejtorëve.

4. Kuvendi është përgjegjës për zgjedhjen dhe revokimin e nënkryetarëve të Odës dhe shumicës së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Odës, në pajtim me këtë Statut dhe aktet tjera normative të Odës.

5. Kuvendi është përgjegjës për shqyrtimin e raporteve për mjetet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e Odës për periudhën mes dy mbledhjeve, si dhe për programet dhe shpenzimet e Odës për vitet vijuese.

6. Kuvendi është përgjegjës për miratimin dhe ndryshimin e Statutit të Odës, Rregullores së Punës së Kuvendit, vendimeve për përvetësimin e pasurisë së paluajtshme në emër të Odës, si dhe për mbikëqyrjen e funksionimit të Odës në përgjithësi, përmes vlerësimit të punës së organeve dhe strukturave të saj.

7. Kuvendi mbledhet së paku një herë gjatë një viti kalendarik dhe e kryen veprimtarinë e vet në mbledhje, në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe të Rregullores së Punës së Kuvendit. Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të rregullta apo të jashtëzakonshme. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit mund të thirren nga Kryetari apo Bordi i Drejtorëve të Odës, me njoftim paraprak shtatëditor të të gjithë anëtarëve. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit mund të thirren nga shumica e anëtarëve të Kuvendit, përmes paraqitjes së kërkesës me shkrim tek Sekretari i Përgjithshëm i Odës, i cili mbledhjen në fjalë do ta thërrasë jo më vonë se pesë ditë pune pas



pranimit të kërkesës së konfirmuar. Anëtarët e Kuvendit do t'i pranojnë të gjitha materialet të cilat do të shqyrtohen në Kuvend jo më vonë se tri ditë para mbledhjes së tij.

8. Kuvendi konsiderohet se është grumbulluar në rastet kur të pranishëm në të janë më shumë se një e treta e anëtarëve të Odës dhe jo më pak se gjysma e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, të ftuar në mënyrë të rregullt në pajtim me këtë Statut dhe aktet tjera normative të Odës. Në rast se kuorumi për mbledhjen e Kuvendit nuk është arritur, atëherë mbledhja do të shtyhet për një datë tjetër jo më vonë se pesë ditë pune nga data fillestare. Kuvendi do të konsiderohet se ka kuorum për marrje të vendimeve në mbledhjen e shtyrë pa marrë parasysh numrin e anëtarëve të pranishëm në të.

9. Vendimet e Kuvendit konsiderohen fuqiplota në rast se për to kanë votuar më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje në të cilat është përcaktuar kuorumi, përveç për rastet kur ky Statut apo aktet tjera normative të Odës kërkojnë votim me shumicë të kualifikuar.

10. Kuvendi mund t'ia delegojë një komisioni të tij, apo ndonjërit prej organeve të Odës, cilëndo kompetencë që ai e bartë në pajtim me këtë Statut, aktet tjera normative të Odës, apo me ligjet e Kosovës, përveç kompetencave bartja e së cilave është shprehimisht e ndaluar me ligjet e aplikueshme.

11. Kuvendi mund të vendosë për shuarjen e veprimtarisë së Odës, në rast se për këtë pajtohen së paku dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit.

12. Lista e anëtarëve të Odës do të mbahet dhe përditësohet nga Sekretari i Përgjithshëm, nën mbikëqyrje të Drejtorit Ekzekutiv të Odës.

Neni 8 – Kryetari i Odës

1. Kuvendi zgjedh Kryetarin e Odës, i cili shërben njëkohësisht si Kryetar i Kuvendit dhe Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Odës. Kryetari zgjedhet me mandat dyvjeçar, me mundësi rizgjedhjeje për një mandat shtesë. Në rast se pozita e Kryetarit të Odës mbetet vakante për çfarëdo arsye, detyrat e Kryetarit do të ushtrohen nga Nënkryetari i Parë, Nënkryetari i Dytë apo anëtari më i vjetër i Bordit deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri nga Kuvendi i Odës.

2. Kryetari përfaqëson Odën në të gjitha funksionet protokollare, publike dhe reprezentative, paraqet mesazhet dhe vendimet e miratuara nga organet e Odës, nënshkruan të gjitha dokumentet dhe aktet normative të miratuara nga Kuvendi dhe Bordi i Drejtorëve dhe mbikëqyr drejtpërsëdrejti punën dhe veprimtarinë e Odës, duke marrë raporte të rregullta nga Drejtori Ekzekutiv.



3. Kryetari siguron mbarëvajtjen e veprimtarisë së Odës në pajtim me ligjet e zbatueshme, këtë Statut dhe aktet tjera normative të Odës, si dhe ekzekutimin e vendimeve të organeve të Odës.

Neni 9 – Bordi i Drejtorëve

1. Bordi i Drejtorëve të Odës zgjedhet nga Kuvendi i Odës për të menaxhuar me veprimtarinë e Odës mes dy Kuvendeve dhe vepron në pajtim me këtë Statut, aktet normative të Odës dhe në dobi të qëllimeve të përcaktuara të Odës. Bordi i Drejtorëve do të bartë të gjitha përgjegjësitë për menaxhimin e Odës të cilat në mënyrë shprehimore nuk i jepen Kuvendit të Odës në bazë të këtij Statuti dhe ligjeve të Kosovës. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve nuk do të kompensohen për kryerjen e detyrave të veta për Odën.

2. Bordi i Drejtorëve ka mandat dyvjeçar, me mundësi rikandidimi dhe rizgjedhjeje, ndërsa mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, përfshirë atë të Kryetarit të Odës, do të skadojë pas marrjes së detyrës nga pasardhësit e tyre, përveç në rastet kur mandati humbet si rrjedhojë e shkarkimit apo dorëheqjes, me ç'rast Bordi i Drejtorëve me vota unanime mund të vendosë për zëvendësimin e anëtarit të dorëhequr apo shkarkuar me një anëtar tjetër i cili këtë mandat do ta mbajë deri në mbledhjen e parë të radhës të Kuvendit të Odës.

3. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga Kryetari, Nënkryetari i Parë, Nënkryetari i Dytë dhe dhjetë anëtarë, të cilët zgjedhen nga mesi i Anëtarëve të Odës. Kryetarin e Odës e zgjedh Kuvendi përmes votimit të drejtpërdrejtë. Në bazë të propozimit të Kryetarit të Odës, Kuvendi zgjedh edhe nëntë anëtarë të Bordit të Drejtorëve. Dy nënkryetarët e Bordit i emëron Bordi i Drejtorëve me shumicë të votave nga mesi i anëtarëve të vet, e në bazë të propozimit të Kryetarit të Odës. Tre anëtarë tjerë të Bordit emërohen nga Kryetari i Odës, në konsultim me dy Nënkryetarët, jo më vonë se tridhjetë ditë pas emërimit në detyrë, për të reflektuar në mënyrën më të mirë të mundshme të gjitha kategoritë e anëtarësimit në Odë. Së paku nga një pozitë në Bordin e Drejtorëve do të jetë e rezervuar për secilën kategori të anëtarësisë në Odë.

4. Bordi i Drejtorëve mund të krijojë trupa dhe komisione të veta për t'i ndihmuar në realizimin e detyrave dhe kompetencave që i ka. Në rast të krijimit të trupave dhe komisioneve të tilla, Bordi i Drejtorëve do të përcaktojë edhe mandatin dhe detyrat e tyre.

5. Bordi i Drejtorëve mund të lidhë marrëveshje me subjekte tjera, mund të autorizojë Drejtorin Ekzekutiv të Odës që të lidhë marrëveshje në emër të Bordit të Drejtorëve, për avancimin e qëllimeve të Odës.

6. Bordi i Drejtorëve mund të miratojë akte normative (rregullore e vendime) që kanë për qëllim detajizimin e funksionimit të Odës, në pajtim me këtë Statut.



7. Bordi i Drejtorëve vendimet e veta i merr me shumicë votash në të gjitha mbledhjet në të cilat të pranishëm janë së paku shtatë anëtarë, e të cilat janë konvokuar në mënyrë të rregullt dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Bordit, e cila do të miratohet nga Bordi i Drejtorëve në pajtim me këtë Statut. Vendimet e Bordit të Drejtorëve merren me shumicën e votave të hapura të të gjithë anëtarëve të tij që janë të pranishëm në mbledhje në të cilat ka kuorum. Në rast se një propozim merr vota të barabarta për dhe kundër, vota e Kryetarit të Odës do të konsiderohet përcaktuese. Përgjatimisht kësaj dispozite, Rregullorja e Punës së Bordit mund të përcaktojë që për disa çështje të caktuara të kërkohet shumica e votave të të gjithë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve ose ndonjë shumicë tjetër e kualifikuar e tyre.

8. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve i fton Drejtori Ekzekutiv, me kërkesë të Kryetarit, Nënkryetarëve apo së paku pesë anëtarëve të tij. Punimet e Bordit të Drejtorëve i udhëheq Kryetari i Odës. Në mungesë të Kryetarit, punimet e Bordit i udhëheq njëri prej Nënkryetarëve ose anëtari më i vjetër i Bordit të Drejtorëve i pranishëm në mbledhje. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve konvokohen me dërgimin e ftesës tek të gjithë anëtarët, së bashku me të gjitha materialet të cilat do të diskutohen në atë mbledhje, jo më vonë se dy ditë para mbajtjes së saj. Mbledhjet e rregullta të Bordit të Drejtorëve do të mbahen jo më rrallë se një herë në dy muaj kalendarik.

9. Me propozimin e Kryetarit të Odës, në punimet e Bordit të Drejtorëve mund të marrin pjesë edhe të ftuar të tjerë, në rast se prania e tyre në mbledhje konsiderohet e rëndësishme për avancimin e veprimtarisë së Odës.

Neni 10 – Komiteti Ekzekutiv

Për të trajtuar çështje urgjente, Oda do ta ketë Komitetin Ekzekutiv, i cili përbëhet nga Kryetari, dy Nënkryetarët dhe Drejtori Ekzekutiv i Odës. Komiteti Ekzekutiv takohet së paku një herë në muaj dhe për të gjitha vendimet e veta e njofton Bordin e Drejtorëve jo më vonë se një javë pas marrjes së tyre. Vendimet në Komitet Ekzekutiv merren me së paku tre vota për, ndërsa në rast të votimit të barabartë, vota e Kryetarit të Odës do të konsiderohet përcaktuese.

Neni 11 – Kryetari dhe Anëtarët e Nderit

1. Përfaqësuesi më i lartë i Ambasadës së Republikës së Turqisë në Kosovë do të mbajë pozitën e Kryetarit të Nderit të Odës dhe do të ketë të drejtë të pjesëmarrjes pa të drejtë vote në punimet e të gjitha organeve dhe strukturave të Odës, të ofrojë rekomandime dhe propozime për vendime të tyre, si dhe ofrimin të këshilla për Odën.



2. Kuvendi i Odës, në bazë të propozimit të Kryetarit të Odës apo Bordit të Drejtorëve, mund t'ia akordojë statusin e Anëtarit të Nderit çdo personi që ai e konsideron se ka merita të shquara për avancimin e marrëdhënieve tregtare e ekonomike mes Kosovës dhe Turqisë. Statusi i Anëtarit të Nderit ia jep çdo pranuesi të gjitha privilegjet që i gëzon çdo anëtar i Odës, përveç të drejtën e votës dhe zgjedhjes në organet e saj.

Neni 12 – Procedurat financiare dhe burimet e të ardhurave

1. Të gjitha organet dhe strukturat e Odës do tu përmbahen të gjitha obligimeve lidhur me raportimin financiar në Kosovë, si dhe dispozitave të këtij Statuti dhe akteve tjera normative të Odës.
2. Bordi i Drejtorëve do të miratojë një rregullore e cila përcakton procedurat e autorizimeve për shpenzime të cilat mund t'i japin Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori Ekzekutiv, Arkëtari apo Bordi i Drejtorëve ose ndonjë trup i tij.
3. Sekretari i Përgjithshëm do të jetë përgjegjës për mbajtjen e evidencës dhe regjistrin të të gjitha të ardhurave dhe përpilimin e bilancit të gjendjes në pajtim me ligjin në fuqi në Kosovë dhe procedurat e përcaktuara në aktet normative të Odës. Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës para Bordit të Drejtorëve për mbarëvajtjen e gjithmbarshme financiare të Odës. Për këto qëllime, Oda mund të angazhojë një ofrues të shërbimeve që është i specializuar dhe certifikuar për të ofruar shërbime të kontabilitetit.
4. Burimet e të ardhurave për Odën janë pagesat e anëtarësisë, donacionet, kontributet e ndryshme me mjete monetare apo në natyrë, dhuratat në formë të sendeve të luajtshme apo paluajtshme, të hyrat e grumbulluara përmes veprimtarisë ligjore të Odës, apo subjekteve të krijuara nga ajo.
5. Përgjegjës për menaxhimin e pronave, pajisjeve, pajimeve, stabilimenteve dhe të mirave materiale të Odës është Drejtori Ekzekutiv, i cili do t'i raportojë Bordit të Drejtorëve mbi gjendjen e tyre në çdo rast që kjo i kërkohet.
6. Viti financiar i Odës do të përkojë me vitin kalendarik, ndërsa raportet financiare mbi veprimtarinë e Odës gjatë vitit paraprak do të paraqiten dhe shqyrtohen medoemos nga Kuvendi në mbledhjen e parë të mbajtur gjatë vitit vijues, pa marrë parasysh natyrën e kësaj mbledhjeje.

Neni 13 – Raportimi i organeve dhe strukturave të Odës



1. Drejtori Ekzekutiv do të raportojë para Bordit të Drejtorëve, në emër të zyrës ekzekutive të Odës dhe të gjithë punonjësve dhe ofruesve të shërbimeve të saj, gojarisht nëpër mbledhje dhe me shkrim kurdo që kjo kërkohet me aktet normative të Odës apo me kërkesë shprehimore të Bordit të Drejtorëve si organ kolektiv përgjegjës për mbarëvajtjen e funksionimit të Odës. Përjashtimisht të gjitha dispozitave tjera dhe kërkesave për raportim, Drejtori Ekzekutiv do t'i dërgojë Bordit të Drejtorëve raport me shkrim mbi gjendjen në Odë, si dhe mbi të gjitha zhvillimet në mjedisin e funksionimit të Odës, çdo gjashtë muaj. Raportet e tilla gjashtëmujore do të miratohen nga Bordi i Drejtorëve dhe mund tu dërgohen të gjithë anëtarëve të Odës.

2. Kryetari i Odës, në cilësinë e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve do të raportojë para Kuvendit në çdo mbledhje të tij. Në rast të mungesës së Kryetarit të Odës, e në bazë të autorizimit paraprak nga Bordi i Drejtorëve, raportimin para Kuvendit në emër të Bordit të Drejtorëve mund ta bëjnë ndonjëri prej Nënkryetarëve apo Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, si dhe Drejtori Ekzekutiv i Odës.

Neni 14 – Ndryshimet e Statutit

1. Ky Statut, si akti më i lartë normativ dhe udhëzues i Odës, mund të ndryshohet dhe plotësohet vetëm në rast se për ndryshimin apo plotësimin në fjalë votojnë së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit për të cilën paraprakisht është konstatuar se ekziston kuorumi.

2. Çdo ndryshim apo plotësim i këtij Statuti do të ketë për qëllim avancimin e funksionimit dhe operabilitetit të Odës dhe arritjen e caqeve të përcaktuara në të.

Neni 15 - Shpërbërja e Odës

1. Oda mund të shpërbëhet vetëm nga Kuvendi i Odës, nëse për këtë votojnë së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit për të cilën është konstatuar kuorumi.

2. Në rast të shpërbërjes së Odës, në vendimin e Kuvendit për shpërbërje do të përcaktohet emri i shoqatës apo fondacionit të cilës do t'i bartet pasuria e mbetur pas mbulimit të gjitha detyrimeve të Odës.

Neni 16 – Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Ky Statut hyn në fuqi me rastin e miratimit të tij nga Kuvendi i Odës.



2. Me hyrjen një fuqi të këtij Statuti, shfuqizohen të gjitha aktet normative të Odës, ndërsa organet e saj obligohen që aktet e reja normative e rregullative t'i miratojnë jo më vonë se tre muaj pas datës së nënshkrimit të këtij Statuti.

3. Të gjitha organet dhe strukturat e Odës do të konstituohen në pajtim me këtë Statut dhe do t'i përmbahen dispozitave dhe frymës së tij gjatë veprimtarisë së tyre.

Prishtinë,
28 Qershor 2016

Në emër të Kuvendit të Anëtarëve të OTKT-së:

Ayhan Albeyoğlu
Kryetar
Oda Tregtare Kosovaro Turke